



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1321 Prot.

Tiranë, më datë 18.11.2022

VENDIM

Nr. 506, datë 18.11.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknikë dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.11.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e Vendimmarrjes për projektin “Ambienti Teknik dhe Biletaria Muzeu Etnografik i Krujës”, me aplikues “Atelier 4” sh.p.k. dhe zhvillues Zyrat e Unops Shqipëri:
 - Në fletët grafike, të hiqet logo e institucionit të Muzeut, e cila është propozuar nga projektuesi;
 - Projekti konstruktiv i strukturave që propozohen, të sillet më i plotë dhe i detajuar, dhe ku ndërhyrjet të respektojnë edhe zonën arkeologjike në të cilën ndodhen;
 - Projekti mekanik i strukturave që propozohen, të sillet më i detajuara, të sakta, dhe të jenë në përputhje me zonën arkeologjike;
 - Të plotësohet projekti inxhinierik me detaje të kullimit të ujërave të shiut;
 - Të sillen propozimet e hijezimit, dhe detaje të realizimit të tyre në ndërtesën e biletarisë;
 2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të zbatohen dhe mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknikë për njoftimin e këtij Vendimi;
 4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Eugen KALLFANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

